

INCOSAI XIX

Meksiko, nëntor 2007

Organizuar nga Zyra Supreme e Auditimit të Federatës së Meksikës



Pjesëmarrësit në kongresin e nëntëmbëdhjetë INCOSAI.

INCOSAI i nëntëmbëdhjetë u mbajt në Meksiko, më 5-10 nëntor 2007, i cili ishte INCOSAI më i madh në histori dhe mblodhi së bashku 145 SAI, 480 delegatë, 21 vëzhgues nga 10 institucione dhe 59 persona shoqërues.

Edhe në Meksikë, motoja e INTOSAI-it, "Experientia Mutua omnibus prodest", ishte sërish tema kryesore e diskutimit, që ka të bëjë me shkëmbimin e njohurive, përvojës, gjetjeve dhe praktikave më të mira mes anëtarëve të INTOSAI-it.

Gjatë fjalës së mbajtur në ceremoninë e hapjes, mikëpritësi i Kongresit, z. Arturo González de Aragon, Auditori i Përgjithshëm i Meksikës tha: "Pavarësisht nga dallimet në traditë, gjuhë dhe perspektivë, qëllimi jonë i përbashkët është nxitja e kulturës së vërtetë të përgjegjshmërisë në secilin prej vendeve tona." Z. González de Aragón vuri në dukje se realizimi i kësaj përpjekje është mbështetur në masë të madhe nga mundësia e diskutimit, shkëmbimit të njohurive dhe përvojës jo vetëm në kongres si një forum ndërkombëtar i hapur, por edhe nga përpjekjet e kryera nga INTOSAI për përhapjen e dijes në fushën e auditimit përmes Grupeve Rajonale, Komiteteve Rajonale, Task Forcave dhe Grupeve të Veçanta.

Numri i vendeve anëtare të INTOSAI-t shkoi në 188 me pranimin e SAI-t të Malit të Zi dhe Singaporit.

Në këtë kongres u miratua Marrëveshjet Meksikos. Marrëveshja mbuloi diskutimet, përfundimet dhe rekomandimet nga tema e parë (menaxhimi, llogaridhënia dhe kontrolli i borxhit publik) dhe tema e dytë (sistemet e vlerësimit të performancës të bazuara në pranimin e treguesve kryesorë).

U bënë disa ndryshime në 3 qëllimet e grupeve të punës:

- U krijua një grup pune mbi treguesit kombëtare për të ndjekur rekomandimet e temës së dytë; drejtuesi i këtij grupi pune ishte SAI i Federatës Ruse.

- Task Forca për Luftën Kundër Pastrimit të Parave Ndërkombëtar u shndërrua në Grupin e Punës për Luftën Kundër Pastrimit të Parave dhe Korrupsionit Ndërkombëtar.
- Grupi i Punës për Privatizimin u shndërrua në Grupin e Punës për Privatizimin, Rregullimin ekonomik dhe Partneritetet publike-private për të pasqyruar një gamë më të gjerë të punës së tij.

U miratuan tetëmbëdhjetë dokumentë zyrtarë të INTOSAI-t, duke përfshirë këtu edhe Deklaratën e Meksikos mbi Pavarësinë e SAI-ve, standardet, udhëzimet dhe praktikat më të mira në fusha të tilla si auditimi financiar dhe i performancës, auditimi mjedisor, si dhe auditimi i borxhit publik.

Raporti i Kryetarit të Komitetit të Financave dhe Administratës përshkruante iniciativat e shumta të miratuara nga Bordi dhe Kongresi në mbështetje të qëllimit të INTOSAI-t për t'u bërë një organizatë model.

Kuota e anëtarësimit në INTOSAI u rrit për herë të parë që nga viti 1983. Çmimi Kandutsch Jorg iu dha SAI-t të Kuvajtit, si dhe çmimi Staats Elmer iu dha katër autorëve (Noel Carisse, Lilian Cotnoir, Carolle Mathieu, dhe John Reed) nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kanadasë për artikullin e tyre, "Ta shndërrojmë botën në një vend më të mirë për të jetuar: Përmirësimi i qeverisjes dhe përgjegjshmërisë në mbrojtjen e mjedisit", në prill të vitit 2006 në Revistën Ndërkombëtare të Auditimit.